

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Komiteti Shtetëror Gruaja dhe Familja

**STRATEGJIA
KOMBËTARE PËR FËMIJËT**

(5-vjeçare)

2001

PËRMBAJTJA

1. HYRJE

2. GJENDJA E FEMIJEVE NE SHQIPERI

- 2.1 Fëmijët në Shqipëri
- 2.2 Aspekti ligjor i të drejtave të fëmijëve në Shqipëri

3. MBIJETESA E FEMIJES

- 3.1 Shëndeti i Fëmijës
- 3.2 Mjedisi familjar dhe kujdesi alternativ

4. MBROJTJA E FEMIJES

- 4.1. Dhuna ndaj fëmijëve, në familje dhe në komunitet
- 4.2. Fëmijët e përfshirë në punë
- 4.3. Mbrojtja e fëmijëve në Komisariate policie dhe në burgje
- 4.4. Fëmijët në zona të veçanta të vendit. Gjakmarrja dhe Hakmarrja

5. ZHVILLIMI I FEMIJES

- 5.1 Arsimi
- 5.2 Argëtimi, shlodhja, veprimtaria kulturore

6. PJESEMARRJA E FEMIJES

- 6.1 Përfshirja e fëmijëve në vendim-marrje

1. HYRJE

Strategjia Kombëtare për Fëmijët, e hartuar në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila shprehimisht përcakton se fëmijët kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti, si dhe të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, është një dokument i rëndësishëm, që përcakton objektivat strategjike të politikës së Qeverisë Shqiptare në këtë fushë të ndjeshme të zhvillimit tonë shoqëror.

Të drejtat civile, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të fëmijëve duhet të mbrohen me përparësi nga çdo individ, familje dhe institucion, sepse kemi të bëjmë jo vetëm me qenie njerëzore përgjithësisht të pambrojtura, por edhe se niveli i sotëm i zhvillimit të tyre fizik e mendor, do të përcaktojë gjithësesi të nesërmen e atdheut tonë.

Nisur nga ky vlerësim, Qeveria Shqiptare do të marrë masat e nevojshme jo vetëm për ndryshimet e domosdoshme në legjislacion dhe përputhjen e tij me dispozitat e Konventës, por edhe për shndërrimin e Strategjisë në aksion kombëtar dhe detyruet për të gjitha institucionet e vendit:

- duke përcaktuar detyra, masa komplekse dhe konkrete në fushën e formimit dhe të edukimit të fëmijëve,
- për pacënueshmërinë e tyre fizike dhe psikologjike në të gjitha mjediset,
- për përmirësimin e kushteve dhe të mjediseve që lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me mësimin dhe formimin e tyre kulturor, me rritjen e nivelit të informacionit, me zhvillimin e shëndetshëm, me shlodhjen dhe argëtimin,
- për mirëtrajtimin dhe nxitjen e prirjeve dhe talenteve të fëmijëve etj.

Qeveria Shqiptare gjithashtu do të mirëpresë angazhimin e gjithë aktorëve socialë, të OJQ-ve të vendit dhe të organizmave e organizatave ndërkombëtare për të ndihmuar në realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët, duke e konsideruar një kontribut fisnik për zhvillimin shoqëror të vendit tonë.

2. GJENDJA

2.1 Fëmijët në Shqipëri

Të mitur në Republikën e Shqipërisë quhen shtetasit nga 0-18 vjeç. Numri i fëmijëve në Shqipëri është 1.396.000 nga 3.320.000 banorë që ka Shqipëria, 33% janë nën 15-vjeç, 40% janë nën 18-vjeç dhe gati gjysma janë nën 25-vjeç. Në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë, fëmija si të gjithë qytetarët gëzon të drejta të barabarta me ligj. Fëmijës i njihen të gjitha të drejtat e pranuar nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës së Kombeve të Bashkuara.

Vdekshmëria foshnjore 0-12 muaj dhe ajo femërore 0-5 vjeç, ka pësuar një ulje të vazhdueshme për këto dhjetë vitet e fundit. Aktualisht ajo është ulur 1/2 e nivelit të viteve 80-90. Por përsëri kjo vdekshmëri vazhdon të mbetet ndër më të lartat në Europë.

Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes, sëmundjet e të porsalindurit dhe sëmundjet diarreike janë shkaqet kryesore të kësaj vdekshmërie.

Kequshqyerja dhe deficitet në disa vitamina dhe mikronutriente si vitamina A, D, jodi, hekuri, mbetet ende një problem madhor. Kështu rreth 25% e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç në nivel kombëtar, vuajnë nga forma e mesme dhe e lehtë e kequshqyerjes, ndërsa 10% janë me formë të rëndë kequshqyerje. Kjo shifër është dy herë më e lartë në zonat verilindore të vendit.

Pamjaftueshmëria jodike e formës së rëndë është vërejtur në 63% të fëmijëve të grupmoshës 10-12 vjeç.

Në dekadën e fundit të shekullit të 20-të, në Shqipëri kishte një sistem kombëtar arsimor të kompletuar me institucione arsimore të të gjitha niveleve nga ai parashkollor deri në institucione arsimore pasuniversitare.

Treguesit sasiorë të zhvillimit të arsimit parauniversitar në vitin 1990 vlerësonin se e ndiqnin: arsimin parashkollor 56% të fëmijëve 3-5 vjeçarë, arsimin e detyruar 8-vjeçar 96-98% e nxënësve, që i përfshinte detyrimi shkollor, arsimin e mesëm rreth 70% të nxënësve që përfundonin klasën e 8-të.

Gjatë periudhës së tranzicionit një ndër dukuritë negative, që u shfaq në arsim, ishte fakti që, në grupmosha të ndryshme fëmijësh ulet ndjeshëm mundësia për të përfutur veçanërisht nga arsimit parashkollor dhe ai i mesëm, edhe në arsimin e detyruar 8-vjeçar ulet numri i nxënësve.

Treguesit statistikore të regjistrimit të fëmijëve në institucionet arsimore në vitin 2000 janë përkatësisht: në arsimin parashkollor: 36% e fëmijëve 3-5 vjeçarë, në arsimin e detyruar 8-vjeçar 543.967 nxënës dhe në atë të mesëm 102.971 nxënës.

Një nga rreziqet më kërcënuese për të rinjtë dhe adoleshentët është edhe **droga**. Adoleshentët (fëmijët 14-18 vjeç) të rrezikuar nga marrja e drogës po shfaqen si grupi marginal më i ri në Shqipëri. Mbi bazën e disa vlerësimeve të OJQ-ve, të cilat veprojnë në këtë fushë, në vendin tonë llogariten rreth 10.000 përdorues droge, 80% e tyre në Tiranë, nga të cilët 40% janë fëmijë dhe të rinj. Ky grup është prezent jo vetëm në Tiranë dhe qendrat e tjera të mëdha urbane, por po shtohet me shpejtësi edhe në qytetet më të vogla.

Më të rrezikuar nga droga janë të rinjtë e familjeve qytetare me gjendje ekonomike të mirë, sepse mundësia për të blerë drogë është faktor për përfshirjen në grupet e përdorimit të saj. Adoleshentët janë më të rrezikuar, sidomos në mjediset e shkollave, sepse në to droga shpërndahet falas. Edhe më të rrezikuar janë të rinjtë të cilët e shpërndajnë dhe e tregëtojnë atë.

Një ndër rreziqet që kërcënojnë jetën e të rinjve është edhe rritja e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, të HIV, SIDA. Aktualisht në Shqipëri llogaritet të ketë rreth 49 raste me SIDA, shumica e të cilëve janë meshkuj të moshës 20-35 vjeç.

Gjithashtu vërehet dhe një rritje e shtatëzanive të padëshiruara tek vajzat e reja. Nga të dhënat rezultojnë se ka një rritje të numrit të aborteve nga viti 1989 deri 1998 në grup moshat 15-24 vjeç.

Nisur nga të dhënat statistikore që disponon Ministria e Rendit Publik, përfshirja e të miturve në veprimtarinë kriminale si autorë në krimet kundër personit dhe pasurisë ka ardhur në zbritje nga viti 1993 në 1999. Por, të miturit përveç evidentimit si autorë në veprimtarinë kriminale, gjatë kohëve të fundit janë evidentuar dhe raste si palë e dëmtuar në krimet seksuale, krimet kundër moralit, etj.

Problem është edhe shtyrja në prostitucion e të miturve brenda dhe jashtë shtetit, si në Itali, Greqi etj. dhe ndërthurja e veprimtarisë së grupeve kriminale të prostitucionit që veprojnë në bashkëpunim edhe me shtetas të huaj.

Një problem shqetësues i dhjetevjeçarit të fundit është gjakmarrja dhe hakmarrja, prej së cilës preken edhe fëmijët drejtpërdrejt ose indirekt, si autorë apo si palë e dëmtuar. Shumë të mitur janë të detyruar të mos ndjekin shkollën për t'iu ruajtur gjaksit, që mund tu marrë jetën për shkak të këtij fenomeni makabër kaq larg qytetërimit të sotëm.

Fëmijët e rrugës përfaqësojnë kategorinë më të vuajtur, më të pambrojtur, më të ekspozuar ndaj shumë rreziqeve si keqtrajtimi, pasiguria, analfabetizmi, kequshqyerja etj. Margjinaliteti i kësaj kategorie ushqehet nga shumë faktorë ekonomikë, socialë, kulturorë, arsimorë dhe familjarë. Vetëm në Tiranë janë identifikuar rreth 800 fëmijë të rrugës, të cilët ushtrojnë "profesionin" e lypsit, të shitësit ambulant, të ilustraxhiut etj.

Fëmijë të pambrojtur, fëmijë jetimë, fëmijë me prindër të divorcuar bien shpesh "pre" e shfrytëzimit dhe dhunimit në format më të larmishme, fëmijë që dhunohen seksualisht, fëmijë që braktisen trotuareve dhe lihen në një cep trotuari nën mëshirën e "bamiresve" kalimtarë, për t'iu falur diçka, fëmijë që rrëmbehen për transplatim organesh apo për qëllime të tjera fitimprurëse, fëmijë që shiten nga prindërit, fëmijë që kequshqehen. Këto kanë qenë objekt shkrimesh në media dhe lajme në TV dhe një pjesë e tyre të trajtuar nga shoqata bamirëse.

Fëmijët e përfshirë në punë dhe aktivitete të tjera fitimprurëse janë fëmijë të cilët e kanë braktisur përfundimisht shkollën, ndërsa të tjerë e frekuentojnë atë dhe kryejnë punë të ndryshme, kryesisht pas mësimit, duke u aktivizuar në ekonominë familjare ose aktivitete jashtë familjes.

Fëmijët e paaftë dhe me zhvillim të vonuar janë një pjesë e komunitetit të gjerë të personave të paaftë në vendin tonë. Për trajtimin e fëmijëve me prapambetje zhvillimi dhe të paaftë ofrohen shërbime institucionale në qendra trajtimi dhe rehabilitimi si: Qendra rezidenciale të zhvillimit në disa qytete dhe Qendra Ditore të zhvillimit në Shkodër dhe në Lezhë. Në këto institucione trajtohen rreth 250 fëmijë të cilët marrin shërbime sociale dhe shëndetësore. Kapaciteti i këtyre institucioneve është i kufizuar në raport me kërkesat e nevojat për këto shërbime. Për plotësimin e nevojave në këtë sektor një rol dhe kontribut të rëndësishëm luajnë fondacionet dhe organizatat jo-qeveritare, të cilat sigurojnë një gamë të gjerë shërbimesh duke sjellë ndryshime cilësore jo vetëm në konceptimin por edhe strukturën e shërbimeve të ofruara.

Me paaftesi mendore e fizike. Sipas ligjit Nr.8092, datë 1.03.1996 "Për shëndetin mendor", në personat me çrregullime mendore, ku përfshihen dhe fëmijët, bëjnë pjesë: personat me probleme të funksionimit mendor, personat me prapambetje mendore, personat që paraqesin çrregullime mendore psikosociale. Personat me zhvillim mendor të vonuar dhe ata me çrregullime mendore, trajtohen falas në institucionet publike të kurimit, të rehabilitimit, të arsimit dhe edukimit. Kur personat janë nën 18 vjeç dhe trajtohen në institucione private, shteti mbulon pjesën e shpenzimeve në masë të barabartë me koston e trajtimit të tyre në institucionet publike. Pra ligji u jep fëmijëve një përkrahje të veçantë duke u siguruar atyre një pjesë të financimit për ta, në rastet e vendosjes së tyre në institucionet private të përkujdesit social.

Sipas disa të dhënave të pjesëshme, rreth 4000 fëmijë janë larguar në emigracion të pashoqëruar nga prindërit (3000 në Greqi dhe 1000 në Itali). Kjo kategori fëmijësh e ndodhur në vende të tjera, larg familjes dhe kujdesit të saj, shpesh ndodhet përballë rreziqeve të shumta si keqtrajtimi, abuzimi fizik e seksual, përfshirja në format e këqia të punës, në trafikë dhe aktivitete të tjera të paligjshme. Në jo pak raste fëmijët shiten nga prindërit ose shfrytëzohen nga rrjete mafioze e kriminale për qëllime fitimi. Një mbrojtje e veçantë u garantohet fëmijëve refugjatë në ligjin Nr.3920 datë 21.11.64 , "Për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj", ku garantohet gëzimi i të drejtave civile që i njihen shtetasve shqiptarë, si dhe në ligjin nr.8432, datë 14.12.98, "Për azilin", duke garantuar mbrojtjen dhe përkrahjen e veçantë për fëmijët refugjatë, fëmijë të familjeve të varfëra, fëmijë që rrezikojnë të përfshihen në veprimtari kriminale, minorene viktime të prositucionit.

Në qytetet e vendeve të huaja, me përqëndrim të madh emigrantësh shqiptarë, do të synohet të ngrihen Qendra Kulturore Shqiptare. Në mjediset e këtyre Qendrave do të ofrohen shërbime të ndryshme për fëmijët e emigrantëve, duke filluar nga kurset për mësimin e gjuhës shqipe e duke vazhduar me shfaqje e projektme filmash, lektorate të ndryshme, shërbime bibliotekare etj.

Shtresa të veçanta fëmijësh kanë edhe më tepër kufizime. Fëmijët romë, përgjithësisht rrojnë në varfëri dhe kushte të vështira sociale. Pjesa më e madhe e tyre jeton në rrugë duke lypur, ndërsa në sezonin e verës një pjesë e tyre sidomos ata që banojnë në qytetet dhe zonat pranë kufirit, shkojnë në Greqi për të punuar. Në këto kushte, një pjesë e tyre, bien viktimë e prostitucionit, dhunimit fizik e moral, keqtrajtohet dhe shfrytëzohet nga rrjetet e aktiviteteve të paligjshme. Në përgjithësi fëmijët romë nuk frekuentojnë rregullisht shkollën, nuk zbatojnë kushtet e detyrimit shkollor dhe për rrjedhojë, karakterizohen nga një nivel i lartë analfabetizmi. Problemet ndaj të cilave janë të ekspozuar fëmijët romë: analfabetizmi, varfëria, të punuarit në moshë të mitur, abuzimi dhe shfrytëzimi për prostitucion, lypësi, vjedhje etj.

Një drejtim tjetër i jetesës së fëmijëve është argëtimi i tyre. Sot, në vendin tonë, pothuajse e gjithë infrastruktura kulturore e argëtuese për fëmijë nuk funksionon, ka ndërruar destinacion apo është drejt degradimit të plotë. Si pasojë mjedise për argëtim a edukim të rinjëve dhe të fëmijëve pothuajse nuk mund të bëhet fjalë. Të vetmet mjedise mbeten banesa ku mund të luajnë, të shohin televizorin dhe të përdorin lojrat elektronike (ata që kanë). Në qytete ekziston vetëm një qendër kulturore e financuar nga shteti që merret vetëm me organizimin e festivalit të këngës së fëmijëve që organizohet për çdo 1 Qershor. Në përgjithësi personeli që merret me edukimin e fëmijëve janë të rritur, që shpesh, janë pedantë dhe të ashpër.

Të detyruar nga mungesa e mjediseve të hapura për ta, fëmijët kalojnë me orë të tëra përpara ekraneve të TV. Ndikimi i tij është aq i dukshëm, sa ka spostuar në nivelet më të ulta, interesat e tjera natyrore të moshës.. Në perceptimin intesiv të realitetit televiziv, në ndikimin e fuqishëm të skenave të dhunës në rrafshin emotiv të fëmijëve dhe në tendencën për të imituar në jetë skenat që ata përjetojnë aq intensivisht në ekran, psikologët dhe sociologët e sotëm, gjejnë burimin kryesor të rritjes së kriminalitetit në moshën e fëmijërisë dhe atë të adoleshencës. Ndaj në këtë drejtim legjislacioni përkatës shërben për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin negativ të medias elektronike në rritjen e dhunës në këto moshë. Niveli i ulët ekonomik i prindërve bën të pamundur plotësimin e shumë nevojave kulturore e argëtuese për fëmijët e tyre. Në shkolla janë tepër të kufizuara mundësitë për kalimin e kohës së lirë dhe të argëtimit pas procesit mësimor. Familja nuk mund t'i kushtojë fëmijëve të gjithë kohën e duhur dhe shpesh nuk kanë përgatitjen e mjaftueshme për të rritur një fëmijë të lumtur. Gjendja social ekonomike e fëmijëve është e njëjtë me të gjithë popullit shqiptar, por veçoritë e lartëpërmendura shtrojnë nevojën e krijimit të mundësive për zbutjen shkallë shkallë të pasojave negative të tranzicionit

të vështirë që kalon vendi ynë që fëmijët të jetojnë fëmijërinë e të marrin pjesë në shoqëri bazuar në të drejtat e tyre.

2.2 Aspekti ligjor i të drejtave të fëmijëve në Shqipëri

Fëmijëve iu garantohen të drejtat e tyre në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 54, i cili sanksionon:

- *Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.*
- *Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejtë të barabarta me të lindurit nga martesë.*
- *Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë e veçanërisht në moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.*

Qeveria Shqiptare i është përkushtuar mbrojtjes së fëmijëve me plotësimin e legjislacionit shqiptar me akte ligjore dhe nënligjore të fushës. Në ligjin Nr.8389 datë 5.08.98 "Për shtetësinë shqiptare", në kuadrin e mbrojtjes së identitetit, çdo personi i njihet e drejta dhe detyrimi për të pasur emrin dhe mbiemrin e tij. Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë është duke punuar për hartimin e projektligjit "Për gjendjen civile", ku do të krijohen kushte më të mira ligjore për respektimin e së drejtës, për ruajtjen e identitetit të tyre, angazhim që rrjedh nga neni 8 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

*Në fushën civile i mituri fiton zotësi të plotë juridike në moshën 18-vjeç. I mituri nga mosha 14-18 vjeç mund të bëjë pjesë në organizata shoqërore, të disponojë atë që fiton me punën e tij, të depozitojë kursimet dhe t'i disponojë vetë këto depozita. Gjithashtu **Kodi Civil** u garanton fëmijëve që nuk kanë mbushur moshën 14-vjeç, të drejtën për të kryer vetë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që i sjellin dobi pa asnjë kundërshtim, ndërsa veprimet e tjera juridike, në emër të tij i kryen përfaqësuesi i tij ligjor.*

Një tjetër e drejtë e rëndësishme e fëmijës në fushën civile është ajo që në të drejtën e trashëgimisë quhet rezerva ligjore. Konkretisht neni 361 i Kodit Civil parashikon trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim si dhe trashëgimtarët e tij të paaftë për punë në se thirren në trashëgimi dhe as të cënojnë me testament me çdo mënyrë qoftë pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar.

Një mbrojtje e veçantë i kushtohet institutit të birësimit në ligjin Nr.7560, datë 17.12.92, "Për birësimet nga të huajt dhe për disa ndryshime në **Kodin e Familjes**". Në këtë ligj parashikohet ngritja e Komitetit Shqiptar të Birësimit, i cili jep pëlqimin e tij përpara gjykatës për birësimin e të miturit nga personi që ka paraqitur kërkesën për birësim. Gjithashtu është ratifikuar Konventa e Hagës "Për mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit". Kjo konventë do të sigurojë njohjen e birësimeve ndërvendase në të gjitha shtetet që do të bëjnë marrëveshje në përputhje me të, duke penguar në këtë mënyrë diskriminimin e fëmijëve të birësuar.

Për sa i takon mbrojtjes së fëmijëve nga ndarja arbitrare e tij prej prindërve, Kodi ekzistues i Familjes dhe Kodi i Procedurës Civile parashikojnë dispozita, ku përcaktohet qartë mënyra e trajtimit të fëmijës mbas zgjidhjes së martesës të prindërve, duke i dhënë të drejtën fëmijës mbi moshën 10 vjeç të zgjedhë

prindin, me të cilin dëshiron të jetojë. Gjithashtu në Kodin e Familjes parashikohet qartë rastet e heqjes së të drejtës prindërore dhe të vendosjes së fëmijës në institucionet e përkujdesjes. Një plotësim dhe përmirësim ligjor do të sjellë hartimi dhe miratimi i Kodit të Familjes. Vonesa në miratimin e një Kodi të ri është mjaft e ndjeshme në veprimtarinë e përditshme të gjykatave. Qeveria duhet të përshpejtojë procedurat për miratimin e tij.

Me iniciativën e Ministrisë është hartuar dhe miratuar në Kuvend Projektligji për disa ndryshime në Kodin Penal ku parashikohen vepra penale që kanë të bëjnë me trafikun e fëmijëve, rrëmbimin e tyre, vrasja për gjakmarrje (një cilësim i tillë synon të parandalojë gjakmarrjen, viktimë e së cilës janë në masë të gjerë fëmijët) dhe janë parashikuar masa më të forta dënimi në rastet e krimeve seksuale kundër fëmijëve.

Mbrojtje e veçantë u garantohej fëmijëve në **Kodin Penal**, ku ka dispozita të posaçme që garantojnë mbrojtjen e fëmijëve prej krimeve kundër tyre. Bazuar në Kodin Penal trajtohen edhe fëmijët e dënuar me rrezikshmëri të ulët duke u percaktuar konkretisht në nenin 52 të tij: "*Gjykata nisur nga rrezikshmëria e pakët, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparëshme e të miturit, mund ta përjashtojë atë nga dënimi. Në këto raste gjykata mund të vendosë dërgimin e të miturit në një institucion edukimi.*"

Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë ka plotësuar me disa amendamente Kodin Penal për disa vepra penale kundër trafikut të fëmijëve, lirisë së personit, të rrëmbimit të personit, duke parashikuar edhe rrëmbimin e fëmijëve me dispozita të veçanta dhe me masa më të rrepta dënimi.

Për sa i takon mbrojtjes procedurale penale, fëmijëve u garantohej disa të drejta themelore si psh. e drejta e fëmijëve mbi 14 vjeç për të dëshmuar në procesin penal dhe për t'u pyetur nga kryetari i trupit gjykues, gjithmonë kur kjo nuk dëmton gjendjen e tyre psikologjike, duke u ndihmuar nga familjarët e tij, ose nga persona të specializuar në fushën e edukimit të fëmijëve; e drejta e realizimit të seancës gjyqësore me dyer të mbyllura, kur kjo ndikon në psikologjinë e fëmijës; e drejta për asistencë ligjore falas kur familjarët e tij nuk kanë mundësi të përballojnë shpenzimet gjyqësore, etj. Në praktikë, gjykimi i çështjeve ku subjekt dhe objekt gjykimi janë të miturit shpesh, nuk bëhet nga gjyqtarë të specializuar vetëm në këtë fushë dhe nuk janë të pranishëm edhe psikologu dhe punonjësi social në to.

3. MBIJETESA

3.1 Shëndeti i Fëmijës

Mbrojtja dhe zhvillimi i shëndetit të fëmijës ka qenë dhe mbetet një synim parësor i Qeverisë Shqiptare dhe veçanërisht i Ministrisë së Shëndetësisë .

Mbështetur në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, çdo shtet pjesëmarrës në të, duhet të marrë masat e menjëhershme për t'i njohur dhe garantuar çdo fëmije të drejtën e jetës dhe për t'i siguruar maksimumin e së drejtës për mbijetesë dhe zhvillimin e fëmijës.

Drejtimet kryesore të punës për përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit të fëmijëve dhe cilësisë së jetës së tyre duhet të jenë:

Ulja e vazhdueshme e sëmundjeve dhe vdekshmëria foshnjore dhe fëmimore nëpërmjet:

a) Përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit shëndetësor;

- b) Rritjes së nivelit të kulturës shëndetësore në familje dhe në shoqëri;
- c) Promovimit të një mënyre jetese të shëndetëshme dhe mbrojtjes së shëndetit;
- d) Rritjes së aksesit ndaj informacionit dhe edukimit shëndetësor për mbrojtjen e shëndetit të fëmijës nga impakti që ato kanë nga dëmtimet e mjedisit;
- e) Rritjes së aksesit ndaj informacionit dhe edukimit shëndetësor për shëndetin e fëmijëve, ushqyerjen, veçanërisht ushqyerjen me gji, higjenën personale dhe mbrojtjen nga aksidentet dhe traumat si dhe çdo formë dhune;
- f) Përmirësimin e mekanizmave kombëtare për monitorimin e ndjekjes së gjendjes shëndetësore të fëmijëve në Shqipëri, e cila do të arrihet duke përmirësuar sistemin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave dhe informacionit në fushën e shëndetit të gruas dhe fëmijës dhe ndarjen e këtij informacioni mbi bazën gender.

Këto janë disa nga përparësitë, të cilat lidhen ngushtë me zhvillimin ekonomik të vendit si dhe me ndihmën ndërkombëtare që i jepet Shqipërisë për të përmirësuar gjendjen ekonomike-sociale në vend. Gjatë viteve të ardhëshme masa të konsiderueshme do të merren për të përmirësuar shëndetin e fëmijës veçanërisht për këto grupmosha: fëmijët e moshës 0-6 vjeç, fëmijët 10-14 vjeç .

Në kuadrin e zbatimit të strategjisë për zhvillimin e vendit dhe zbutjen e varfërisë, do të përmirësohet cilësia e kujdesit shëndetësor (shërbimet rehabilituese, edukimi, rikrijimi i mundësive) mbështetur në të drejtat e integritetit social, tek e drejta për zhvillim individual, e drejta për trajtimin mjekësor, psikologjik, dhe trajtimin funksional.

3.2 Mjedisi familjar dhe kujdesi alternativ

Interesi më i lartë i fëmijës duhet të bëhet çështja bazë. Mbrojtja e interesave personale dhe private të fëmijës është gjithashtu po aq e rëndësishme për rritjen dhe zhvillimin e tij. Kujdesi shëndetësor dhe e drejta për të pasur siguri në familje janë të drejtat bazë të tij. Këto ndiqen edhe nga të drejtat e tjera si e drejta për të jetuar me prindërit e tij ose të saj ose nëse një fëmijë është i ndarë nga njeri apo të dy prindërit ai ose ajo duhet të mbajnë kontakte të rregullta me të dy prindërit.

Duke qenë se fëmija ka të drejtën të zgjedhë shkollën e tij dhe prindërit nuk duhet të ushtrojnë dhunë, me dëmtime trupore apo mendore ose ta keqtrajtojnë por janë të parët që kanë përgjegjësinë për të siguruar zbatimin e të drejtave të fëmijës. Prindërit duhet që në mënyrë të barabartë bashkërisht të kujdesen për fëmijën pavarësisht nga fakti nëse jetojnë bashkë ose janë të divorcuar, apo pavarësisht nga fakti që fëmija jeton me njerin prej tyre.

Për këtë qëllim është e nevojshme ngritja e qendrave të kujdesit social në qytete, të cilat të ndihmojnë në përzgjedhjen sa më të drejtë se me cilin nga prindërit duhet të rrijë fëmija duke u mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës. Duhet parë me vëmendje rastet e përjashtimit nga kujdesi prindëror, duke verifikuar me cilin nga prindërit fëmija është i rrezikuar si dhe në rastet kur fëmija abuzohet fizikisht ose seksualisht nga prindërit, apo kur partneri ka dhënë shembuj të dhunës mbi partnerin. Një mjedis familjar i mirë është një mjedis që ndihmon në mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës. Në situatat kur fëmijët nuk kanë asnjë mbrojtje nga prindërit e tyre zgjidhen forma të tjera të kujdesit alternativ. Ato janë: institucione të kujdesit social, familjar, familje ushqyese.

Kategoritë e fëmijëve të fokusuar për mbështetje sociale janë fëmijët **jetimë** (biologjikë e socialë) dhe fëmijët me **paaftësi mendore e fizike**. Ligji ka mjaft parashikime të rëndësishme në drejtim të përcaktimit të punonjësve socialë në institucionet e përkujdesjes sociale ku është e vendosur kjo kategori fëmijësh, si dhe përcaktimin e parimeve bazë të politikës rehabilituese dhe edukuese për fëmijët me shkallë të ndryshme prapambetje mendore. Por, me gjithë përmbajtjen e tij bashkëkohore, ligji, i fut fëmijët në kuadrin e trajtimit të të gjithë personave që futen në këtë kategori dhe vetëm në disa dispozita parashikon në mënyrë të shprehur kategorinë e fëmijëve.

Në ligjin nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", janë përfshirë kategoritë e personave që kanë shkallë të ndryshme të paaftësisë fizike dhe të drejtat që kanë ata, sidomos në aspektin ekonomik, si: sigurimin e nivelit ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, punë të përshtatshme, lehtësim nga pagimi i taksave, mundësi kurimi, arsimim, dhe veprimtari çlodhëse dhe argëtuese.

Por ligji nuk parashikon në mënyrë të posaçme të drejtat e fëmijëve me paaftësi fizike ndaj është e nevojshme që mënyra e trajtimit të fëmijëve me paaftësi fizike të parashikohet në një ligj të veçantë, megjithatë në realitet, ndryshe nga parashikimet ligjore, trajtimi i tyre, në pjesën më të madhe është favorizues dhe në nivelin e duhur.

Me gjithë ndryshimet pozitive në konceptimin dhe realizimin e politikave sociale të trajtimit të të paafteve problematika e kësaj kategorie të fëmijëve të marginalizuar paraqitet komplekse dhe kërkon ndërhyrje efikase në drejtim të përcaktimit të strukturës së institucioneve, llojshmërisë së shërbimeve dhe nxitjes së llojshmërisë, që e mban fëmijën më pranë komunitetit dhe sigurojnë një integrim dhe rehabilitim më të shpejtë të tij në jetën normale. Kjo llojshmëri duhet realizuar dhe zhvilluar më tej nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare.

Përpunimi i politikave efikase dhe programimi i objektivave të qartë të mbrojtjes sociale, është i kushtëzuar nga *identifikimi i kategorive të fëmijëve të rrezikuar dhe vlerësimi i nevojave të tyre specifike*.

Mbrojtja sociale e fëmijëve duhet të mbështetet në dy forma: *Institucionale rezidenciale (institucione të përkujdesit social, qendra zhvillimi) dhe jorezidenciale (modele dhe regjime të reja më pranë përfituesve)*, duke iu dhënë përparësi të dytave pasi janë më pak të kushtueshme dhe me rezultate më të ndjeshme e të prekëshme nga përfituesit.

Për fëmijët me të meta fizike dhe mendore shteti merr përsipër të sigurojë mbrojtje dhe zhvillim social në institucione të cilat garantojnë dinjitetin e tyre, favorizojnë autonominë dhe lehtësojnë integrimin në komunitet.

Trajtimi institucional i fëmijëve ofrohet si shërbim klasik rezidencial për fëmijët jetimë, biologjikë dhe socialë, fëmijët me paaftësi mendore dhe fizike. Për plotësimin e nevojave dhe kërkesave në rritje të kësaj kategorie do të vazhdohet në rrugën e fuqizimit të institucioneve të Përkujdesit Shoqëror, rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe shpërndarjen më të drejtë gjeografike e tyre.

Nisur nga konsiderata se shërbimet sociale nuk janë monopol i shtetit dhe bazuar në kontributin e rëndësishëm të OJQ-ve, do të nxitet më tej ndihmesa e tyre në këtë fushë.

Bashkëpunimi mes OJQ-ve dhe strukturave të tjera do të çonte në një informacion, mbrojtje dhe argëtim më të madh të fëmijëve në Shqipëri. Në këtë mënyrë do të realizohet një koordinim më i suksesshëm i punëve. Përgjegjësit e punëve do të ndahen sipas profileve përkatëse të çdo strukture kështu që do të arrihet një infrastrukturë e mirëfilltë dhe frytëdhënëse.

- ◆ **Qendra ditore** për mbështetje dhe trajtim psikosocial, edukim dhe këshillim të kategorive të fëmijëve të rrugës, fëmijët e abuzuar dhe keqtrajtuar, fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën.
- ◆ **Qendra pritëse** (strehëza) për pritjen dhe strehimin e përkohshëm të fëmijëve të riatdhesuar, të larguar pa prindërit në emigracion, minorenët viktime të prostitucionit etj.
- ◆ **Qendra Rehabilitimi** për fëmijët dhe të rinjtë e droguar dhe të alkolizuar, për trajtimin psikosocial, këshillim, rehabilitim dhe riintegrim në jetën normale.
- ◆ **Kujdestaria ushqyese** - një formë tjetër në ndihmë të fëmijëve jetimë e cila synon në vendosjen e fëmijëve në kushte të përshtatshme, të cilat sigurojnë përkujdesje dhe mirërritje normale të fëmijëve. Alternativa të tjera të kësaj linje do të jenë edhe *birësimi i fëmijëve në familje të reja dhe kujdestaria në distancë*.
- ◆ **Shtëpi-familje** për trajtimin e fëmijëve handikapatë dhe jetimë të cilët lënë institucionet pas moshës 14-vjeç.
- ◆ Qendra polivalente (multidisiplinare) të cilat ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh si këshillim, konsulencë juridike, mbështetje psikosociale, asistencë në familje, kurse formimi, trajnimi, informacion, asistencë për zgjidhjen e situatave të jashtëzakonshme të personave në rrezik/vuajtje, (p.sh. aksident në familje, prindër në burg, abandonim i fëmijëve nga prindërit etj.)

Pushteti vendor të përcaktojë cilët fëmijë duhet të trajtohen me përparësi, që kanë më tepër nevojë dhe në mënyrë tipike nuk përfitojnë nga shërbimet bazë sociale.

Komiteti Gruaja dhe Familja si dhe pikat e tij të kontaktit në pushtetin vendor nisur nga vlerësimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, se familja është mjedisi natyror për rritjen e fëmijëve dhe përgjegjësja kryesore për zhvillimin e tyre normal, të nxisin mbështetjen me asistencë sociale më të diferencuar:

- *Për fëmijët e familjeve të varfëra,*
- *me probleme të mprehta sociale*
- *me kryefamiljar nënën*

Drejtorja e Koordinimit të Politikave Rinore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve synon në konceptimin e agjencive të fëmijëve i cili mbështetet në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve dhe presupozon mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nga të rinjtë, dhe gjithashtu edukimin vullnetar dhe zhvillimin e aktiviteteve krijuese që të rinjtë zhvillojnë në favor të fëmijëve. Duke qenë se të rinjtë janë shumë afër moshës dhe psikologjisë së fëmijëve, dhe gjithashtu fëmijët mund të mësojnë nga të rinjtë atë çka në të ardhmen do të jetojnë, mund të krijohet një komunikim i cili do të pasuronte jetën e fëmijëve dhe do të angazhonte energjitë e të rinjve në këtë çështje sa fisnike aq edhe të rëndësishme.

Kujdesi prindëror, përgjegjësia e prindërve, ndarja nga prindërit, ribashkimi i familjes, perkujdesja për fëmijën, fëmijët e privuar nga mjedisi familjar, birësimi, transferimi i paligjshëm dhe mosrrikthimi i fëmijëve, keqtrajtimi i fëmijëve dhe lënia pas dore, janë disa nga përparësitë që kërkojnë angazhimin e Qeverisë për të bërë të mundur dhe siguruar njohjen e parimit se prindërit kanë të njëjtat përgjegjësi për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

Për të rritur efektivitetin e partneritetit shtet-shoqëri civile bazuar në legjislacionin përkatës do të nxitet:

- *Krijimi pranë njësive të qeverisjes vendore i departamenteve të përkujdesit për fëmijë për të siguruar një mbulim më efikas të nevojave të fëmijëve të rrezikuar.*
- *Ngritje e Qendrave të Shërbimit Social në qytetet kryesore të vendit për drejtimin e institucioneve të kujdesit rezidencial edhe për fëmijët, dhe harmonizimi i shërbimeve, lehtësimi i bashkëpunimit me të gjithë aktorët që veprojnë në fushën e kujdesit dhe zhvillimit të fëmijëve.*

Përmirësimi i legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale për të siguruar mbrojtjen më të mirë të të drejtave të fëmijëve në nevojë dhe rishikimi i kuadrit ligjor:

- *Hartimi dhe miratimi i Kodit të Ri të Familjes ku do të gjejnë rregullim të gjitha problemet që kanë të bëjnë me kujdestarinë dhe fëmijët e braktisur.*

Të krijohet një fond shtesë i buxhetit pranë institucioneve qendrore publike që menaxhojnë shërbimet sociale, duke krijuar kushte më lehtësuese për thithjen e financimeve të donatorëve të ndryshëm.

Ngritja dhe fuqizimi i një sistemi të plotë informacioni për grumbullimin e të dhënave për problematikat e fëmijëve të rrezikuar, mbi bazën e të cilave, të mund të përpunohen objektiva, programe dhe projekte efikase të zhvillimit të shërbimeve sociale.

Vendosja e punonjësit social në institucione të tilla si shkolla, qendra shëndetësore, burgje të minorenëve dhe pranë komuniteteve në funksion të ngritjes së një rrjeti të plotë të shërbimeve sociale.

4 MBROJTJA E FWMIJWS

Qeveria Shqiptare duhet të ndihmojë sidomos, fëmijët të cilëve u kërcënohet zhvillimi normal. Duke pasur parasysh se institucionet e shtetit nuk mund të mbulojnë tërësisht këtë problem, atëherë del e nevojshme të bashkëpunohet në këto drejtime: sensibilizimi i opinionit mbi të drejtat e fëmijëve; mbrojtje direkte e të drejtave të fëmijëve nga një staf i specializuar; largimi i fëmijëve nga lojrat e rrugës dhe afrimi tek lojrat në grup; zhvillimi i aftësive intelektuale dhe fizike të fëmijëve; komunikimi mes fëmijëve dhe të rinjve; edukimi vullnetar; angazhimi i të rinjve në fushën e edukimit social; trajnimi i prindërve dhe i mësuesve, për një punë të suksesshme me fëmijët; strehimi i fëmijëve jetimë dhe atyre të rrugës.

4.1 Dhuna ndaj fëmijëve, në familje dhe komunitet

Para fillimit të punës edukuese me prindërit dhe fëmijët, është i nevojshëm informimi i opinionit me thelbin e konventës për të drejtat e fëmijëve dhe kushtet që ajo vendos për një fëmijëri sa më të lumtur.

Gjithashtu një mbrojtje direkte nëpërmjet marrjes së informacionit dhe dhënies së këshillave, për zgjidhjen e problemeve që kanë fëmijët dhe gjithashtu angazhimin e institucioneve shtetërore të specializuara për këtë qëllim, do të fillonte një eksperiencë e re në marrjen në mbrojtje të fëmijëve.

Interpretimi juridik i neneve të Konventës duhet të realizohet në bashkëpunim me ekspertë të cilët të përgatisin materialin e duhur që do të botohet në një broshurë dhe do të shpërndahet nëpër shkolla e institucione publike.

Edukimi në familje është një element shumë i rëndësishëm i edukimit të fëmijëve. Familja është institucioni i vetëm ku fëmija mund të marrë të dhënat e para të edukimit dhe të sjellurit në shoqëri. Si rrjedhojë investimi në favor të forcimit të familjes si institucion edukues dhe kujdestar, çon në investimin tek fëmija që nesër do të jetë i rritur.

Veç kësaj do të jetë e domosdoshme të hapej një diskutim publik me pjesëmarrjen e prindërve, fëmijëve dhe psikologëve në mediat lokale, në mënyrë që impakti social të jetë sa më i madh.

Në kushtet e sotme jo të gjithë prindërit kanë mundësi t'i kushtojnë kohën e duhur dhe tu krijojnë fëmijëve të tyre kushte të mjaftueshme argëtimi në kohën e lirë. Përveç kësaj, shumë prindër nuk kanë edhe përgatitjen e duhur për të qenë prindër të suksesshëm., sepse, shpesh, kjo detyrë realizohet sipas përvojës së fëmijërisë së tyre dhe figurës së prindit tradicional. Si pasojë shpesh prindërit për arsye autoriteti, dashurie ose emocioni, abuzojnë me lirinë dhe të drejtat e fëmijëve të tyre, duke vënë në rrezik edhe të ardhmen e vetë fëmijëve. Ndërkohë shpesh kemi si rezultat: të rritur të squllët, "të pafuqishëm" dhe të paafte të zgjidhin problemet që u dalin.

Edukimi i prindërve, vjen e bëhet sa i nevojshëm aq edhe i domosdoshëm. Dhe kjo nuk duhet të jetë diçka spontane por një proces i vazhdueshëm dhe metodik, i pasuruar me elemente të shkencave të tilla si sociologjia dhe psikologjia.

Edukimi formal në shkollë është një element tjetër i rëndësishëm i edukimit të fëmijëve. Sipas Konventës të gjithë fëmijët kanë të drejtën e arsimimit falas dhe në mënyrë periodike, sipas programeve të përcaktuara nga shtetet palë.

Nisur nga një sistem i centralizuar arsimor, Shqipëria sot trashëgon një sistem arsimor të pëlqyeshëm. Duke shtuar këtu edhe përpjekjet e shumë institucioneve dhe organizmave joqeveritare për reformim të këtij sistemi, mund të themi se pas disa dekadash ky sistem do të jetë afër niveleve të kërkuara nga nevojat e komunitetit.

Megjithatë, rrjetit të shkollave i mungon elementi i komunikimit mes shkollave dhe i kalimit të kohës së lirë pas procesit mësimor. Kështu fëmijëve që ndjekin shkollën u mungon një hapësirë dhe mundësi për t'u marrë me aktivitete krijuese.

4.2 Fëmijët e përfshirë në punë

Duke patur parasysh gjendjen ekzistuese të fëmijëve të trafikuar për qëllime prostitucioni apo shfrytëzimi ekonomik, Qeveria Shqiptare përcakton edhe përparësitë për mbrojtjen e tyre nga trafikimi jashtë shtetit me qëllim shfrytëzimi për vjedhje, për shpërndarje droge etj. apo ndarja arbitrare nga familja.

Ndaj janë të nevojshme dhe urgjente përmirësimet ligjore për të mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi ekonomik, sidomos për dënimin sa më të ashpër nga organet gjyqësore të të gjithë atyre që rrëmbejnë, trafikojnë apo shfrytëzojnë fëmijët brenda dhe jashtë Shqipërisë për qëllime të përfitimit ekonomik.

Kodi i Punës i garanton një mbrojtje të veçantë fëmijëve duke ndaluar marrjen në punë të të miturve nën 16 vjeç. Por ky ndalim nuk zbatohet për të miturit jo më pak se 14 vjeç gjatë pushimeve shkollore. Gjithashtu në dispozitat e këtij kodi parashikohet një reduktim i kohës së punës për të miturit nën 18 vjeç në 6 orë në ditë.

Inspektoriati Shtetëror i Punës (IShP) përcakton target grupet, rajonet specifike, sektorët dhe format e punësimit që janë me përparësi në fushën e punës; bashkëpunon mes të gjithë palëve për zbutjen ose zbatimin e ligjeve në këtë fushë. Por, prej tij nuk mbahet gjithmonë parasysh dallimi mes punonjësve nga pikëpamja e moshës.

Inspektorët e Punës veprojnë në përputhje me politikat strategjike shtetërore dhe vlerësimin e zgjidhjen e situatave për marrëdhëniet e punës së fëmijëve në vendet e punës që operojnë. Prej tyre punohet gjithashtu në përcaktimin e target grupeve prioritare, fëmijët e punësuar që duhet të mbështeten të parët dhe fëmijët që kanë punuar në punët e vështira me më pak mbrojtje. Në mungesë të ligjit të veçantë për punën e fëmijëve duhet marrë në konsideratë Konventa nr.182 e ILOs e nënshkruar edhe nga vendi ynë për "Punën e rëndë të fëmijëve".

Rëndësi të veçantë ka trainimi i kombinuar me fëmijët e punësuar, punëdhënësit e tyre dhe familjet, pra bashkëpunimi i të gjithë sektorëve: punëdhënës, departamente të qeverisjes lokale, OJQ që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, grupe profesionistësh, sindikata, institucione shëndetësore dhe universitetet etj.

Kujdes të veçantë kërkon puna e fëmijëve jashtë moshës ligjore për punë, shoqëruar me pagesat nën minimalen ligjore, shkeljet ligjore të së drejtës për sigurime shëndetësore dhe shoqërore (diferenca për moshën për punë dhe moshën për sigurim).

Në kuadrin e Kodit të Punës me akte nënligjore duhen përcaktuar vendet konkrete të punës që ndalohen për të miturit nga 14-18 vjeç dhe pajisen me leje të veçantë të organit kompetent për punësimin e të miturve.

Qeveria është e angazhuar për miratimin në parim të Konventës Nr.182 "Format më të këqia të Punës së Fëmijëve, 1999" dhe Rekomandimin Nr.190 Eliminimi i Formave më të këqia të Punës së Fëmijëve të Organizatës Botërore të Punës.

Në kuadrin e ratifikimit të kësaj Konvente duhet të parashikohen amendamente në Kodin e Punës, për sa i takon kriteret e punës, të specifikohen të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit lidhur me të miturit si dhe përgjegjësia e personit juridik për shkeljet eventuale.

Gjithashtu duhet të rishikohet ligji për Inspektoriatin Shtetëror të Punës, si në aspektin administrativ, duke krijuar hallka të posaçme lidhur me të miturit, ashtu edhe në aspektin juridik, duke i dhënë prioritet kontrollit lidhur me punën e të miturve.

Me përparësi është *ndërtimi i kapaciteteve nëpërmjet trainimit të inspektorëve të punës* për pajisjen e tyre me njohuri dhe aftësi të tilla teknike e profesionale që ka puna e fëmijëve si kategori tepër specifike në tërë punëmarrësit në përgjithësi. Ky trainim duhet të orientohet në legjislacionin e punës në përmirësimin e tij të vazhdueshëm në lidhje me përmirësimin e kushteve të punës, të sigurisë dhe të shëndetit në punë.

Rëndësia e trainimit të zakonshëm dhe specifik për një kontroll efektiv të vendit të punës për fëmijët. Në programet e tilla duhet të përfshihen jo vetëm inspektorët, por edhe fëmijët që punojnë, familjarët e tyre të rritur, në rradhë të parë prindërit, punëdhënësit dhe institucionet përkatëse që janë të përfshira në këtë proces.

Kushtet e vështira të punës, pagesa nën minimalen ligjore, shkelja e të drejtës për sigurime shëndetësore dhe shoqërore duhet të jenë përparësi e punës së Inspektoriateve të Punës.

Për këtë duhet bërë:

- Evidentimi i sektorëve ku punojnë fëmijët,
- Respektimi i Kodit të Punës dhe i akteve nënligjore për të drejtat e tyre, kushtet e punës, kohëzgjatja ,rreziqet e vendit të punës.
- Eliminimi i punës së fëmijëve, synimi afatgjatë, ndërsa synim afat mesëm e afat shkurtër është përmirësimi i kushteve të punës së fëmijëve.

4.3 Mbrojtja e fëmijëve në Komisariate policie, dhoma paraburgimi dhe burgje

Trajtim i veçantë u duhen bërë fëmijëve në Komisariate policie dhe Burgje. Kjo mbrojtje duhet parë si në aspektin e ndalimit të përdorimit të dhunës fizike ndaj fëmijëve në këto institucione, në marrjen e masave parandaluese për mos përfshirjen e fëmijëve në krim, krijimin e kushteve të përshtatshme për edukim dhe mirëritje të fëmijëve në dhoma paraburgimi dhe burgje, si dhe në rehabilitimin moral dhe shoqëror të fëmijëve që kanë kryer krime. Rëndësi i duhet dhënë trainimit të inspektorëve të policisë kriminale dhe asaj të rendit për të drejtat e fëmijëve. Fëmijët duhet të trajtohen dhe ndahen në mjedise të veçanta në komisaritet e policisë në rrethe, po ashtu edhe në dhomat e paraburgimit. Përfshirja e sociologëve dhe psikologëve që do të trajtojnë fëmijët edhe si palë e dëmtuar edhe si autorë të veprës penale duhet parë si një prioritet me rëndësi të veçantë për rehabilitimin e fëmijëve. Sektorë të veçantë të Ministrisë së Rendit Publik duhet të merren me ndjekjen e problemit të përfshirjes së fëmijëve në krim, parandalimit të kriminalitetit femënor.

Për këtë arsye duhet që Qeveria të:

- Qeveria të përgatisë një projekt-ligj “Për Sistemin e Drejtësisë Femënore në Shqipëri” ku të përfshihet organizimi i sistemit të dënimit, mbrojtjes, kujdesit dhe rehabilitimit të fëmijëve që janë autorë të krimit.
- Me riorganizimin e Ministrisë së Rendit Publik, në Policinë kriminale të krijohet një zyrë e re për problemin e fëmijëve dhe trafikut të qënieve njerëzore. Kjo zyrë të bashkëpunojë ngushtësisht me Gjykatat. Ajo duhet të ndjekë problemet e mbrojtjes së fëmijëve nga veprimtaritë e paligjshme, shfrytëzimi për prositucion, shfaqje e materiale pornografike, për të parandaluar rrëmbimin, shitjen e shfrytëzimin për vjedhje apo prositucion, për përdorimin e drogave dhe pijeve alkoolike e duhanit, etj.

- Me kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, të mbahet parasysh rritja e kërkesave për trajtimin e të miturve të paraburgosur.
- Në programet mësimore të Akademisë së Rendit Publik dhe ato të Policisë në çdo rreth të përfshihen tema trainimi të oficerëve të policisë për njohjen me aktet ndërkombëtare e kombëtare të të drejtave të fëmijëve dhe trajtimin specifik të fëmijëve, kur ata bëhen objekt i punës së policisë.
- Përfshirja e punonjësit social ose psikologut në trajtimin e fëmijëve si palë e dëmtuar apo si autorë të veprës penale në stacione policie, dhoma paraburgimi dhe burgje.
- E rëndësishme duhet parë edhe krijimi i një Gjykate për të Miturit si një organ i specializuar për gjykimin e fëmijëve dhe çështjeve të fëmijëve.

4.4 Fëmijët për zona të veçanta të vendit, Gjakmarrja dhe Hakmarrja

Procesi i zhvillimeve demokratike në Shqipëri u shoqërua me kriza të mëdha politike, institucionale, ekonomike, psikologjike. U rishfaqën vrasjet në seri për shkak gjak dhe hakmarrjeje dhe si pasojë, përveç të tjerash ngujimin e shumë fëmijëve në "burgun shtëpiak" dhe braktisjen e shkollës. Gjendja paraqitet veçanërisht e vështirë në rrethet e veriut të vendit.

Në këtë drejtim është punuar për përcaktimin e gjendjes, strukturën dhe shpërndarjen gjeografike të vrasjeve për hakmarrje e gjakmarrje, me qëllim hartimin e strategjisë për zonat më të prekura dhe përparësitë e punës. Përveç evidentimit të rasteve të gjakmarrjes dhe hakmarrjes rëndësi ka edhe përcaktimi i tyre *si raste të vjetra dhe të reja*, pasi këto të fundit paraqesin një rrezikshmëri më të madhe dhe çojnë në një numër më të madh ngujimesh, ndërkohë që vrasjet e vjetra për gjakmarrje paraqesin më shumë mundësi për pajtim.

Për këto punojnë misione me përfaqësues të pleqësive të fshatrave, që merren me pajtimin e gjaqeve në zona të ndryshme si dhe përfaqësues të ligjit, pa përjashtuar shoqatat, që merren me këto probleme, por sidomos shkollën. Ato synojnë gjetjen e shkaqeve që çuan në gjallërimin e kësaj dukurie, në këto kohë, disa prej të cilave janë: mosrespektimi i ligjit; mosfunksionimi si duhet i aparatit shtetëror; migrimi i popullsisë në përmasa të mëdha dhe tërësisht të pakontrolluar, madje jo vetëm në shkallë vendi, por edhe në shkallë krahine duke pasur parasysh rrethanat historike, politike, shoqërore, kulturore, psikologjike të popullsisë.

Të gjithë aktorët që veprojnë në këtë fushë duhet:

Të evidentojnë sidomos *për moshën e subjektit të krimit* të vrasjeve për gjakmarrje dhe hakmarrje në rastet kur ata janë të mitur, sipas statistikave të 1997 pjesëmarrja e të miturve dhe të rinjve arrin në 6.5%.

Të njohin më mirë personalitetin e subjekteve të vrasjeve për hakmarrje e gjakmarrje, rëndësi ka edhe studimi i nivelit arsimor të tyre. Ndaj është e domosdoshme që ky mision të bashkërendojë punën e tij me shkollën. Nga statistikat rezulton se kryesisht këta subjekte janë meshkuj, pra një analizë psikologjike sociale e rasteve nënkupton *pjesëmarrjen e psikologëve, punonjësve socialë në komision*.

Në strategjinë e tij komisioni mund të synojë sigurimin e jetës së njeriut nëpërmjet *funksionimit normal të aparatit shtetëror*, çarmatimit të popullsisë, pajtimit politik, edukimit me vlerat e tolerancës e mirëkuptimit, pajtimit të familjeve të ngujuara, përfshirjes së gjithë fëmijëve në shkollë dhe edukimi i tyre me ndjenjat e qytetarise, organizimit të një pune të përbashkët të organeve shtetërore dhe shoqatave e OJQ-ve kundër hakmarrjes e gjakmarrjes. Janë disa shoqata joqeveritare që veprojnë në këtë fushë në zonën veriore të vendit.

Për realizimin e kësaj strategjie është e domosdoshme *organizimi i punës në disa nivele si në atë të organeve të policisë, prokurorisë, gjykatës, pra organeve shtetërore për parandalimin e vrasjeve*, por edhe me organizma të tilla shtetërore si Komiteti Gruaja dhe Familja që mund të zhvillojë një veprimtari më të gjerë me gratë e fëmijët në edukimin e tolerancës e mirëkuptimit në familje e në komunitet në këto zona.

Rol të vecantë ka shkolla dhe organizatat joqeveritare si për punën me familjen ashtu dhe me shkollën për edukimin e fëmijëve kundër ndjenjës së hakmarrjes.

Mjetet e informacionit publik dhe mediat e ndryshme mund të ndikojnë pozitivisht për parandalimin e hakmarrjes dhe gjakmarrjes.

5 ZHVILLIMI

5.1 Arsimi

Qeveria shqiptare vlerëson se sigurimi i një sistemi arsimor cilësor është parakusht për përgatitjen e kushteve integruese të vendit në rajon e më gjërë. Zhvillimet politike, ekonomike e social kulturore të 10 vjeçarit të fundit kanë diktuar procesin e rivlersimit të gjithë sistemit arsimor dhe riformimit të tij me qëllim që të sigurojë formimin e individit të aftë të jetojë në një shoqëri demokratike, të njohë dhe të përvetësojë vlerat themelore të demokracisë që mbështeten në respektimin e të drejtave të njeriut, të demokracisë, tolerancës dhe solidaritetit njerëzor, i aftë të ushtrojë të drejtat dhe përgjegjësitë e tij. Në këtë kuadër është hartuar projekt strategjia afatmesëm dhe afatgjatë e zhvillimit të arsimit objektivat e së cilës orientohen në 4 drejtime kryesore:

- **Normalizmi i sistemit arsimor**
- **Rritja e afikasitetit të brendshëm të sistemit**
- **Sigurimi dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë**
- **Integrimi gradual i sistemit dhe niveleve të tij në zhvillimet rajonale si dhe në kontekstin europian**

Qeveria shqiptare vlerëson se veprimtaria e të gjitha institucioneve arsimore në të ardhmen duhet të sigurojë një nivel të lartë të promovimit, përvetësimit dhe zbatimit të të drejtave të fëmijëve duke e vënë theksin në 4 rekomandime themelore dhe strategjitet që duhet të ndjekë Ministria e Arsimit dhe Shkencës për realizimin e tyre.

a) **Sistem arsimor cilësor nën moton “fëmija mbi gjithshka”:**

Synon të përmirësojë sistemin arsimor me qëllim që të sigurojë një trajtim global, koherent që do plotësojë nevojat e fëmijëve për një arsimim dhe formim bashkëkohor që t'i përshtatet kushteve të zhvillimit të vendit dhe më gjerë si dhe të mbështesë marrjen e vendimeve multidisiplinare në nivel ministrie.

Strategjitë

- Konsolidimi dhe rinovimi i sistemit arsimor publik cilësor dhe falas në nivelet e arsimit parashkollor, arsimit të detyruar dhe të mesëm si dhe shtimit të alternativave private të arsimit në të gjitha nivelet.
- Promovimi i metodologjive bashkëkohore interaktive që venë në qendër fëmijën dhe e integrojnë në mënyrë aktive në rrugën e njohjes nëpërmjet procesit të kërkimit dhe zbulimit individual dhe në grup.
- Hartimi i kurrikulave të reja dhe përmirësimi i atyre egzistuese në gjithë sistemin arsimor parauniversitar
- Sigurimi i bazës materiale didaktike dhe asaj kërkimore, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, për të nxitur dhe rritur shkallën e kërkimit, efektivitetin e përvetësimit të kurrikulës arsimore.
- Sigurimi i një niveli bashkëkohor të formimit të studentëve në Universitetet e mësuesisë dhe kualifikimi i vazhdueshëm i mësuesve në shërbim .
- Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe psiko-pedagogjike (mjek, punonjës social, psiko-pedagog) për fëmijët në të gjithë nivelet e sistemit parauniversitar. Ngritja e qendrave këshillimore që do të ofrojnë asistencë psiko-pedagogjike për fëmijët me probleme të ndryshme.
- Sigurimi i një rrjetit funksional të institucioneve arsimore në të gjithë vendin, në veçanti për zonat e thella rurale, nëpërmjet përqendrimit të shkollave, për të rritur nivelin cilësor të mesimdhënies për fëmijët.
- Në kuadrin e strategjisë së përgjithshme të qeverisë për zbutjen e varfërisë, strategjia afatmesme e arsimit, për nxënësit që vijnë nga familje të varfra do të synojë t'ju garantojë :
 - tekste dhe materiale shkollore falas
 - veshmbathje dhe trajtim me ushqim për një vakt

• Në arsimin parashkollor do të synohet:

- në 5 vitet e ardhëshme të tërhiqen në institucionet parashkollore publike 50% e fëmijëve 3-5 vjeçarë, të mundësohet dhe mbështetet sigurimi i edukimit alternativ nëpërmjet kopshteve private dhe programeve të edukimit të fëmijëve në shtëpi.

• Në arsimin 8- vjeçar do të synohet:

- në ristrukturimin administrativ të funksionimit të shkollës së detyruar duke e ndarë ciklin fillor nga cikli i lartë i arsimit 8-vjeçar, me qëllim që të krijohen hapësira për zhvillimin paradite të mësimin në filllore si dhe të sigurohet një fleksibilitet më i madh i procesit mësimor-edukativ.
- zbutja e dukurisë së braktisjes së shkollës duke e ulur këtë tregues në kufij të papërfillshëm
- plotësimi i nevojave për arsimin special, përmirësimin e kushteve të zhvillimit të mësimin, kualifikimin e personelit mësimor, zbatimi i metodologjive të avancuara të edukimit.
- rritja e nivelit të përgatitjes së mësuesve në tërësi dhe atyre pa arsim përkatës deri në zëvendësimin gradual të këtyre të fundit
- sigurimi i arsimit të fëmijëve në nevojë dhe me probleme sociale (fëmijë të ngujuar për shkak të gjakmarrjes, fëmijë të braktisur etj)

• Në arsimin e mesëm do të synohet në:

- shtrirjen e arsimit të mesëm të profilizuar në të gjitha rrethet e vendit për t'iu përgjigjur më mirë nevojës për një formim të përshtatshëm të nxënësve me prirje individuale si dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe arsimit të lartë.
- rritja e tërheqjes së nxënësve që mbarojnë arsimin e detyruar në arsimin e mesëm me një ritëm vjetor 2%.
- hartimi i dokumentacionit ligjor për rritjen e autonomisë së shkollave të mesme në drejtim të programeve mësimore, administrimit dhe financimit të shkollave
- për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe për të siguruar një formim të përshtatshëm të fëmijëve për jetën, në arsimin profesional do të synohet në ndryshimin e raportit të kontigjenteve të nxënësve të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit profesional nga 85-15% në 70-30% në favor të arsimit profesional.

b) Sistem efektiv informimi:

Synon sigurimin e një sistemi të detajuar të informacionit (sipas moshës dhe seksit), të besueshëm dhe krahasues që do të mundësojë identifikimin e nivelit të arsimit dhe edukimit të fëmijëve, si dhe problemeve të ndryshme social-ekonomike që do të kushtëzojnë prioritetet e ndërhyrjes politike në fushën e arsimit

Strategjitë

- Realizimi i një programi informues që do të realizojë rigrupimin e të gjithë treguesve statistikorë për fëmijët që braktisin shkollën, që shfrytëzohen në punë, që përdorin drogën, që shfrytëzohen për prostitucione etj. për të krijuar database kombëtare në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore dhe të shoqërisë civile
- Identifikimi i fëmijëve që braktisin shkollën dhe zhvillimi i programeve që do të kufizojnë këtë dukuri
- Sigurimi i shpërndarjes së informacionit në organizata të ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare, në median elektronike dhe të shkruar me qëllim që të sensibilizojë opinionin kombëtar dhe ndërkombëtar për probleme që kërkojnë zgjidhje emergjente si dhe të sigurojë partneritet në veprimet që duhen të ndërmeren në nivele ndërministrare.
- Në të gjitha shkollat e arsimit të detyruar dhe kopshtet do të realizohet futja e librit shkollor për secilin nxënës që do të përmbajë: informacion të përgjithshëm për njohuritë dhe aftësitë e fëmijës, gjëndjen e përgjithshme fizike si dhe informacion për prindërit.

c) Studimi i të drejtave të fëmijës në programet shkollore

Synon të sigurojë njohjen dhe përvetësimin e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të fëmijëve të paraqitura në Konventën e Kombeve të Bashkuara duke i përfshirë këto në kurrikulin shkollor të orientuar në të drejtat dhe detyrat e fëmijëve.

Strategjitë

- Përfshirja në kurrikulin shkollor të koncepteve të asimilueshme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duke filluar nga institucionet parashkollore deri në ato të arsimit të mesëm:
 - në nivelet e arsimit parashkollor dhe fillor do të trajtohen përvoja që lidhen me sjelljet shoqërisht të pranueshme dhe jo të dhunshme si dhe respektimin e tjetrit në kontekstin e klasës.

- në ciklin e lartë të arsimit 8- vjeçar dhe në shkollën e mesme, në veçanti në lëndë të tilla si histori, gjeografi, edukim qytetar, sociologji, gjuhë dhe letërsi, shkencat ekonomike do të trajtohen konceptet abstrakte të të drejtave të njeriut ku përfshihen njohja dhe të kuptuarit e koncepteve filozofike, politike dhe juridike.
- Njohja dhe studimi i të drejtave të njeriut në shkollë do të synojë në përvetësimin e koncepteve bazë të drejtësisë, barazisë, lirisë, paqes, dinjitetit njerëzor dhe demokracisë. Ky proces do të jetë njëkohësisht intelektual dhe zbatues.
- Të gjitha degët e mësuesisë së Universiteteve do të përfshinë në kurrikulin e tyre studimin: e deklaratave dhe konventave kryesore që trajtojnë të drejtat e njeriut si dhe njohjen e funksionimit organizatave ndërkombëtare që merren me mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut.
- Do të sigurohet kualifikimi i vazhdueshëm i mësuesve në shërbim që do të mundësojë njohjen dhe përvetësimin e praktikave bashkëkohore pedagogjike në fushën e njohjes së të drejtave të njeriut dhe realizimit të tyre nëpërmjet metodave dhe materialeve të përshtatëshme.

5.2 Argëtimi, shlodhja, veprimtaria kulturore

Koha e lirë për fëmijët duhet përpunuar si një koncept bashkëkohor, ku të gërshetohet loja me çlodhjen e mësimin duke zbutur shikimin e tepërt të emisioneve televizive. Nga ana tjetër duhen shtuar mjediset e gjelbëra dhe ato të lodrave e këndet sportive. Mungesa e mjedisve çlodhëse dhe edukuese për fëmijët duhet të jetë në vëmendje të të gjithëve. Për ta duhet të krijohen e të shtohen sa më shumë në sasi dhe llojshmëri si mjedise publike dhe private, qendra kulturore edhe në shkolla.

Për këtë qëllim:

- *Qeveria, vec shtesës në buxhetin e shtetit për investime në këtë fushë, duhet të nxisë çdo inisiativë private apo të OJQ-ve për përmirësimin e objekteve të tilla që lidhen me shëndetin fizik, mendor e shpirtëror të fëmijëve.*
- *Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të hartojë politika për krijimin e një mendësie të re në këtë drejtim konkretisht edukimin vullnetar të fëmijëve nga të rinjtë.*
- *OJQ-të për fëmijët duhet të luajnë një rol pozitiv në edukimin vullnetar të fëmijëve. Të krijohet ura e komunikimit mes të rinjve dhe fëmijëve si një binom i përsosur.*

6 PJESEMARRJA

6.1 Përfshirja e fëmijëve në vendim-marrje

Synon të sigurojë pjesëmarrjen efektive dhe të përgjegjshme të fëmijëve në vendimarrje në përputhje me aftësitë e tyre, në të gjitha nivelet e arsimit në shkollë, në nivel lokal dhe qendror.

Strategjitë

- Plotësimi i akteve normative të funksionimit të shkollës me nene të veçanta që i njohin të drejtën fëmijëve të jenë pjesëmarrës në vendimarrjet që lidhen me procesin mësimor, veprimtaritë brënda

dhe jashtë shkollës si dhe të përcaktohen instrumentat dhe modalitetet që do të bëjnë efektive këtë pjesëmarrje në:

- informimin dhe marrjen e vendimeve së bashku me trupin pedagogjik
 - të marrin përgjegjësi kundrejt vetvetes, shkollës, familjes dhe komunitetit
 - të praktikojnë forma të delegimit dhe përfaqësimit
 - të marrin pjesë në bordet drejtuese të shkollës
- Zhvillimi i programeve dhe projekteve në nivel shkolle, rajoni dhe më gjerë që do të përgatisin fëmijët për t'u integruar në jetën e shoqërisë demokratike, t'i aftësojë të ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarit, t'i iniciojnë në jetën politike dhe ekonomike të vendit (shtrirja e mëtejshme e projektit të "Qeverisë së nxënësve")
 - Promovimi i programeve që përgatisin fëmijët për jetën në sajë të bashkëpunimit të shkollës me institucione të tjera sociale. Fëmijët do të kenë avantazhin të bashkëpunojnë:
 - me familjen nëpërmjet përfshirjes efektive të komunitetit të prindërve
 - me komunitetin lokal nëpërmjet pjesëmarrjes së këtij të fundit në jetën e shkollës dhe të fëmijëve në mënyrë vullnetare.
 - me institucionet sociale dhe politike, nëpërmjet organizimit të debateve me personalitete publike, nëpërmjet vizitave në institucionet publike lokale dhe nacionale si dhe organizimin e veprimtarive jashtëshkollore
 - botën e kulturës nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në veprimtari sociale, artistike, shkencore dhe sportive.

E drejta e fëmijëve për të thënë fjalën për veten e tyre është e drejtë njerëzore. Konventa për të drejtat e Fëmijës e sanksionon edhe njëherë këtë të drejtë.

Tanimë janë të pranishme Qeveritë dhe Parlamentet e nxënësve në shkollat e mesme. Organizimi i tyre në rrjet do të jetë më i frytshëm për qeverisjen e nxënësve pasi do të përfshijnë pjesën më të madhe të fëmijëve. Krijimi i rrjetit është koordinimi i punës midis shkollave për të bërë një organizim më të mirë mes tyre dhe fëmijëve duke promovuar gjerësisht zërin dhe mesazhin e nxënësve.

Rëndësi e veçantë i duhet dhënë rritjes së pjesëmarrjes së fëmijëve në nivel lokal dhe kombëtar që ata të mund të ushtrojnë të drejtën për të luajtur një rol aktiv në shoqëri. Pjesëmarrja e fëmijës duhet parë e lidhur ngushtë me përfshirjen e tyre në aktivitetet e organizuara nga shkolla, komuniteti dhe Qeveria. Opinioni i fëmijës duhet tërhequr në nivel lokal dhe atë kombëtar për të gjitha ato vendime që merren dhe që kanë të bëjnë me jetën e tyre.

- *Ngritja e zyrave në çdo bashki, komunë të vendit për fëmijët do të bënte që marrja në konsideratë e opinioneve të fëmijës dhe rritja e pjesëmarrjes së tyre të bëhet më e sigurtë, ndërsa krijimi i Klubeve të Fëmijëve duhet të bëhet në çdo shkollë në rang bashkie dhe komune.*

Ministria e Arsimit synon:

- *Plotësimin e akteve normative të funksionimit të shkollës me nene të vecanta që i njohin të drejtën fëmijëve të jenë pjesëmarrës në vendim marrje që lidhen me procesin mësimor, veprimtaritë brenda dhe jashtë shkollës si dhe të përcaktohen instrumentat dhe mënyrat që do ta bëjnë efektive këtë pjesëmarrje në:*
 - a) Informimin dhe marrjen e vendimeve së bashku me trupin pedagogjik,
 - b) Të marrin përgjegjësi ndaj vetvetes, shkollës, familjes dhe komunitetit,

- c) Të praktikojnë forma delegimi dhe përfaqësimi,
 - d) Të marrin pjesë në bordet drejtuese të shkollës.
- Zhvillimi i programeve dhe i projekteve në nivel shkolle, rajoni e më gjerë që do të përgatisin fëmijët për t'u integruar në jetën e shoqërisë demokratike, i aftëson të ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarit. (Shtirirja e mëtejshme e projektit të qeverive të nxënësve).
 - *Nxitja e programeve që përgatisin fëmijët për jetën në sajë të bashkëpunimit të shkollës me institucione të tjera sociale:*
 - a) Me familjen përmes një bashkëpunimi të ngushtë me prindërit.
 - b) Me komunitetin vendor, përmes pjesëmarrjes së këtij të fundit në jetën e shkollës.
 - c) Me institucionet sociale dhe politike nëpërmjet organizimit të debateve me personalitete publike, përmes vizitave në institucione publike vendore dhe kombëtare.
 - d) Me institucionet kulturore përmes pjesëmarrjes aktive në veprimtari sociale, artistike, shkencore dhe sportive.
 - Veç kësaj kërkohet një punë e gjithanëshme ndërgjegjësuese për ndryshimin e mentalitetit të të gjithë shoqërisë për ta pranuar si një të drejtë të pakundërshtueshme të *drejtën e fëmijës për të marrë pjesë në të gjitha vendimet që merren për të në familje e komunitet*. Kjo është ndër veprimtari të me kohëzgjatje më të madhe pasi nuk mund të realizohet vetëm me përmirësim legjislativ por do mobilizimin e të gjithë organizatave qeveritare e joqeveritare, shoqërisë së tërë për të përmirësuar vetveten.

**PLANI I VEPRIMIT
TË QEVERISË SHQIPTARE
PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR FËMIJËT**

- ◆ *Një herë në vit, të zhvillohet analizë në Këshillin e Ministrave për problemet sociale të fëmijëve dhe të përcaktohen objektiva për strukturat sociale të përkujdesit shoqëror.
Qeveria Shqiptare - Një herë në vit*
- ◆ *Zbatimi i këtij plani veprimesh do të financohet nga Buxheti i Shtetit (Ministritë sipas problemeve përkatëse) si dhe përmes projekteve në këto fusha, të financuar nga donatorë të ndryshëm të ndjeshëm e të interesuar në përmirësimin e gjendjes së fëmijëve.*

MBIJETESA

1. Të reduktohet vdekshmëria amtare nën 10-të për 100 000 lindje gjallë
2. Të reduktohet vdekshmëria infantile nën 10-të për 1 000 lindje gjallë.
3. Të reduktohet anemia nga hekuri në gratë shtatzëna nga 45 % nën 25 %.
4. Të arrihet mbulimi vaksinal i fëmijëve mbi 95 % (përdorimi i vaksinave efektive, vaksinimi i plotë, zbatim korrekt i skemave të tyre në kohë, zinxhiri ftohës etj.)
5. Të arrihet që 90 % e nënave të ushqejnë fëmijën e tyre vetëm me gji për 4-6 muajt e parë të jetës dhe 60 % e tyre të vazhdojnë këtë ushqyerje me gji deri në vitin e parë të jetës.
6. Të pakësohen 50 % e vdekjeve në fëmijët nën 5 vjeç nga sëmundjet diarreike.
7. Të reduktohen 30 % në vdekjet e shkaktuara nga sëmundjet akute të rrugëve të frymëmarrjes në fëmijët nën 5 vjeç dhe të ulet incidenca e këtyre sëmundjeve në 15 %.
8. Të reduktohet 50 % kequshyerja e formës së rëndë dhe mesatare tek fëmijët deri 5 vjeç.
9. Të rritet mbulimi i shtatzënive të ndjekura nga personeli shëndetësor në 90 %. Të arrihet që 90 % e grave shtatzëna të kenë kryer 4 vizita gjatë shtatzënisë së tyre.
10. Të rritet përqindja e lindjeve me ndihmë mjekësore të kualifikuar në 95 %.
11. Të rritet në 90 % numri i foshnjave të moshës deri në 3 vjeç që marrin shërbime të kujdesit shëndetësor parësor në intervale të caktuara.
Pikat 1-11 Ministria e Shëndetësisë, 2001 - 2010
12. Miratimi i Projektkodit të Familjes.
Ministria e Drejtësisë Qershor 2001
13. Hartimi i projektligjit Për Gjendjen Civile.
Ministria e Drejtësisë Qershor 2001.
14. Rishikimi i ligjeve që trajtojnë problemet e fëmijëve jetimë: Ligji për Birësimet dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 510 "Për kriteret e Vendosijes në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror"
Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Drejtësisë 2001.
15. Specializimi i Sektorit të Edukimit dhe futja e punonjësit social në Institucionin e vuajtjes së dënimit nga të Miturit,
Ministria e Drejtësisë, 2003 - 2005.
16. Specializimi i gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjet e të miturve në seksionet e posaçëm që do të ngrihen,

Ministria e Drejtësisë, 2001 - 2005.

17. Ngritja e një institucioni edukimi për të miturit që kryejnë një vepër penale, kur shkalla e rrezikshmërisë së veprës është e ulët.

Ministria e Drejtësisë.

18. Në drejtorinë e Policisë Kriminale të Ministrisë së Rendit dhe në të 12 Drejtoritë e Policisë së Qarqeve të krijohen zyra për problemin e fëmijëve dhe trafikut të qenieve njerëzore.

Ministria e Rendit Publik

19. Krijimi i qendrës pritëse për fëmijët emigrantë të pashoqëruar.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, financuar nga homologia Italiane 2001.

20. Observator kombëtar për njohjen dhe monitorimin e veprimtarisë së institucioneve që trajtojnë fëmijët handikapatë (fizikë e mendorë).

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (APNSHS), Shoqata Dokita 2001.

21. Decentralizimi i shërbimit social për fëmijët jetimë në institucione më të vogla dhe sa më pranë jetës familjare.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (APNSHS), Banka Botërore

22. Përfundimi i projektit pilot për kujdestarinë për fëmijët në nevojë dhe miratimi i ligjit "Për kujdestarinë në Republikën e Shqipërisë"

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (APNSHS), Shoqata joqeveritare për fëmijët (Trusti European i Fëmijëve).

23. Zgjerimi gradual çdo vit i fondit social si dhe shpërndarja e tij në pushtetin lokal sipas nevojave të diferencuara nga APNSHS.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Pushtetit Lokal, 2002

24. Të merren masa konkrete për ndërgjegjësimin dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve gjatë udhëtimit në rrugë, detyrimi i prindërve apo drejtuesve të automjeteve për të pasur karrike të veçantë për fëmijët e mitur.

Ministria e Transportit dhe OJQ-të që veprojnë në këtë fushë.

MBROJTJA

1. Në programet mësimore të Akademisë së Rendit Publik dhe në Institutin 1 vjeçar të Policisë të parashikohen tema dhe leksione të veçanta për njohjen dhe respektimin e Konventës së të drejtave të Njeriut e të drejtave të fëmijëve.

Ministria e Rendit Publik, 2002.

2. Hartimi i programeve për trainime specifike të inspektorëve shtetërorë të punës, të punëdhënësve dhe familjarëve të fëmijëve-punëmarrës.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (ISHP) 2002.

3. Programimi i masave konkrete për mënjanimin e punës së rëndë për fëmijët, për përmirësimin e kushteve të punës.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (ISHP).

4. Krijimi i një Komiteti multisektorial me përfaqësues nga të gjithë dikasteret që trajtojnë problemet e punësimit të fëmijëve.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (ISHP)

5. Hartimi i programeve për spitalet pediatrike për trajtim profesional të fëmijëve të keqtrajtuar, rehabilitimin e tyre dhe trainimin e mjekëve për këtë fushë.

Ministria e Shëndetësisë.

6. Programimi i trainimit të prindërve dhe mësuesve për njohjen e tyre me të Drejtat e fëmijëve.
Ministria e Arsimit dhe Shkencave, OJQ-të për fëmijët.
7. Programimi i ndërmarrjes së Studimeve sociologjike mbi problemet e fëmijëve dhe familjeve të tyre,
Instituti pedagogjik, Fakulteti i Shkencave Sociale, MASH
8. Botimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe shpërndarja për të gjithë nxënësit e sistemit arsimor të detyruar dhe institucioneve e specialistëve për të drejtat e fëmijëve,
Komiteti Gruaja dhe Familja .
9. Organizmi i një diskutimi publik në mediane të shkruar dhe atë elektronike për problemet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Komiteti Gruaja dhe Familja dhe OJQ-të për të drejtat e fëmijëve .
10. Përfundimi i projektit "Emanuel" si qendra e specializuar e trajtimit psikofizik të adoleshentëve përdorues të drogës dhe alkoolit.
Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (APNSHS), Komuniteti Emanuel 2001
11. Miratimi i ligjit "Për veprimtarinë e OJQ-ve në Republikën e Shqipërisë".
Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, 2001
12. Krijimi i strukturave bashkiake dhe komunale, si subjekte të drejtimit të institucioneve sociale që trajtojnë fëmijët jetimë, të varfër dhe handikapë.
Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (APNSHS), Ministria e Pushtetit Lokal, 2001.
13. Zëvendësimi gradual i Shtëpive të Fëmijëve (Rezidenca masive) me institucione më të vogla si Shtëpi-familje, Fshatra SOS, etj.
Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (APNSHS), Ministria e Pushtetit Lokal, Rrjeti i OJQ, 2001-2002
14. Në përputhje me Axhendën për Veprim të Stokholmit të hartohet "Plani Kombëtar për të luftuar shfrytëzimin seksual të fëmijëve" me objektiv parandalimin, mbrojtjen, mjekimin, kujdesin si dhe bashkëpunimin rajonal.
Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve , Ministria e Arsimit dhe Shkencave, Komiteti Gruaja dhe Familja, 2001.
15. Hartimi i projektligjit për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale
Ministria e Drejtësisë, 2002
16. Nënshkrimi i dy protokolleve Alternative të Konventës së OKB-së për të Drejtat e fëmijëve si dhe i Konventës së Këshillit të Evropës "Për ekzekutimin e të Drejtave të Fëmijëve".
Ministria e Drejtësisë, 2002.
17. Kalimi i sistemit të paraburgimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe rritja e kërkesave për trajnimin e fëmijëve të paraburgosur nga punonjës të specializuar,
Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Rendit , 2002-2003
18. Ngritja e Institucionit të veçantë të vuajtjes së dënimit për të miturit e dënuar,
Ministria e Drejtësisë 2001-2003

ZHVILLIMI

1. Studimi i shpërndarjes demografike të nxënësve dhe hartimi i një programi të plotë të arsimit të detyruar.
Ministria e Arsimit dhe Shkencave, 2001.
2. Studimi për përqëndrimin e shkollave të arsimit 8-vjeçar në zonat fshatare, (Pilotim)
Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe OJQ-të e fushës, 2001 -2003.

3. Programimi për përmirësimin e bazës materiale didaktike për kopshtet dhe shkollat,
Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe OJQ të fushës, 2001-2003.
4. Ndërtimi dhe rehabilitimi i shkollave të arsimit bazë të zonave të perspektivës,
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2001-2003.
5. Ndërtimi ose përshtatja e mjediseve për konvikte pranë shkollave të arsimit bazë në zonat e thella për të rritur frekuentimin e shkollës dhe mënjanimin e dukurisë së analfabetizimit,
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, OJQ, 2001-2003.
6. Studimi për strategjinë e rikualifikimit të mësuesve, të pedagogëve dhe personelit administrativ,
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2001-2003.
7. Krijimi i Agjensive të fëmijëve,
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
8. Organizmi i kampionateve të ndryshme sportive ndërmjet shkollave të mesme, tetëvjeçare dhe të rretheve,
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit dhe Shkencave
9. Ngritja dhe pasurimi i bibliotekave në shkollat e vendit,
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
10. Organizmi i festivaleve të këngës për fëmijë, në shkallë kombëtare,
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
11. Shndërimi i mjediseve të oborreve të shkollave, në mjedise argëtimi të fëmijëve pas përfundimit të orarit të mësimin.
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
12. Krijimi i një sistemi të dhënash kombëtar për të adresuar problemet konkrete të arsimit për përmirësimin e kualifikimit :
 - Nëpërmjet kualifikimit cilësor universal
 - Trajnimi i mësuesve pa arsim përkatës
 - Trajnimi i mësuesve në shërbim
 - Rritja e pjesëmarrjes së prindërve në problemet e shkollës
 Ministria e Arsimit dhe Shkencave, INSTAT
13. Krijimi i një sistemi arsimor cilësor (fëmija mbi gjithçka):
 - infrastruktura, përmbajtja
 - standartet në mësimdhënien dhe në të mësuarit e nxënësit
 Ministria e Arsimit dhe Shkencave
14. Krijimi i një sistemi efektiv informimi
 - tregues arsimor (Ministria e Arsimit dhe Shkencave)
 - tregues social (Ministria e Punës, INSTAT)
 - tregues ekonomik (Ministria e Financave, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik., INSTAT)
 - tregues kulturor (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve)
 - koordinimi (Komiteti Gruaja dhe Familja)
15. Arsimi për të gjithë
 - Përfshirja e grupeve vulnerabël në arsim, (grupe etnike, fëmijë me probleme, në burgje, romë, fëmijë të ngjuar, përdorues droge, alkooli, trafikimi, fëmijë të ndikuar nga lufta dhe konfliktet, etj).
 - Përfshirja e të rriturve pa arsim
 - Arsim për vajzat pa arsim
16. Fuqizimi i strukturës ekzistuese për të ndjekur zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët, duke përgatitur raporte në Qeveri për këtë, ose ngritja e një strukture të re për këtë qëllim.

Komiteti Gruaja dhe Familja, Ministria e Arsimit dhe Shkencave, Drejtoritë Arsimore, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, OJQ, komunitetet e prindërve.

17. Përfshirja e moduleve të njohjes së dokumenteve kryesorë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe instrumentet që sigurojnë zbatimin e tyre, në të gjitha degët e mësuesisë së Universiteteve,

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2001-2003.

18. Trainimi i rreth 800 inspektorëve dhe mësuesve për eksperimentimin e programeve të integruara për edukimin qytetar dhe për të drejtat e njeriut,

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me UNESCO-n, 2002-2003.

19. Studimi analizues i programit ekzistues të "Edukatës qytetare" dhe i përvojave jashtëprogramore për të drejtat e njeriut,

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me UNESCO-n, 2001-2002.

20. Hartimi i programeve të integruar për të drejtat e njeriut, i moduleve trainuese për qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut si dhe i manualeve për mësuesit për nivelin parauniversitar dhe të materialeve didaktike,

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me UNESCO-n, 2002.

21. Eksperimentimi i programeve të integruar dhe manualeve të mësuesve,

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2003.

22. Shtrirja e shërbimeve sociale për fëmijët në komunitetin dhe forcimi i kompetencave të pushtetit vendor në këtë drejtim.

Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, (APNSHS), Banka Botërore, Pushteti Vendor, 2001-2005

23. Krijimi i Qendrave Ditore për fëmijë - si institucione të mirëfillta të edukimit psiko-social.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (APNSHS), Bashkitë dhe Komunat, 2001

24. Krijimi i Qendrave Rezidenciale për këshillim dhe training për prindërit me fëmijë që kanë probleme të veçanta sociale.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, (APNSHS), Bashkitë, Komunat, Rrjeti i OJQ, 2001-2002

25. Përfshirja e punonjësit social në organikat e institucioneve që trajtojnë fëmijë si në shkolla, burgje, institucione shëndetësore, etj.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, 2001-2002

PJESËMARRJA

1. Organizimi në shkallë kombëtare i rrjetit të qeverive të nxënësve, koordinimi i veprimtarisë së tyre dhe krijimi i sistemit të të dhënave për to.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli Rinor.

2. Publikimi i rregullores së Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencave për funksionimin e qeverive të nxënësve në shkolla.

3. Veprimtari të ndryshme (seminare, tryeza të rrumbullakta, debate televizive, botime) për të ndërgjegjësuar shoqërinë shqiptare se pjesëmarrja në vendimmarrje e fëmijëve në familje, shkollë, shoqëri, është një e drejtë njerëzore që ndikon në demokratizimin e shoqërisë në tërësi.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Komiteti Gruaja dhe Familja, OJQ për të drejtat e fëmijëve.